



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 4981 Prot.

Tiranë, më 17.9. 2021

URDHËR

Nr. 330, Datë 17.9.2021

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” NË “FINANCË KONTABILITET”, NË UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ” GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Financë Kontabilitet” me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në “Financë Kontabilitet”, Fakulteti i Ekonomisë, në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Financë Kontabilitet”, në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, fillon në vitin akademik 2021-2022.
3. Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislationin në fuqi.
4. Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

